



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr _____ Prot.

Tiranë më, _____._____.2023

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në zbatim të Ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e Mbrojtura”, Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM-së nr. 102, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura e të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, të Urdhrit të Kryeministrit Nr.188, datë 15.11.2022 “Disa ndryshime në urdhërin nr. 26, datë 03.02.2020, të Kryeministrit “Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, shpall 1 (një) vend të lirë pune, në Administratën e Zonave të Mbrojtura Kukës, për pozicionin si më poshtë:

1. ROJE MJEDISORE

NË ADMINISTRATËN E ZONAVE TË MBROJTURA KUKËS

KËRKESAT E POZICIONIT TË PUNËS:

Kriteret e përgjithshme:

- 1) Të kenë shtetësinë shqiptare;
- 2) Të jenë jo më pak se 18 vjeç;
- 3) Të gëzojnë zotësi të plotë për të vepruar;
- 4) Të plotësojnë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojnë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- 5) Të jenë të aftë për punë nga ana shëndetësore;
- 6) Të mos jenë të dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- 7) Të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

Kriteret e veçanta:

- 1) Të zotërojnë minimalisht diplomë të shkollës së mesme;
- 2) Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 1-vit, preferohet eksperiencë pune në sektorë të ngjashëm;
- 3) Të ketë aftësi komunikuese dhe të punës në grup;
- 4) Të njohë programet bazë të paketës Office;
- 5) Preferohet të zotërojnë një gjuhë të huaj.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, këto dokumenta:

- a) Kërkesë me shkrim;
- b) Curriculum vitae (CV) në formatin *Europass*;
- c) Fotokopje të Diplomave Universitare (nuk është e nevojshme të jenë të përkthyer);
- d) Fotokopje të Pasaportës;
- e) Certifikatë Familjare;
- f) Dëshmi Penaliteti;
- g) Raport mjekësor për aftësinë në punë;
- h) Fotokopje të librezës së punës;
- i) Certifikata të trajnimeve, aftësive kompjuterike dhe gjuhësore;
- j) Dokumente të tjera relevante mbi eksperiencat e mëparshme, të tilla si: letra reference, certifikata, etj.

Kandidatët e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet e aplikimit brenda datës 10.02.2023, ora 14:00, në adresën si në vijim: Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura “Bulevardi Dëshmorët e Kombit”, nr. 1, Tiranë, Shqipëri.

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtëpërdrejta.

Bazuar aplikimit tuaj, sqarojmë se vetëm kandidatët të cilët do të plotësojnë kushtet për kualifikim, do të njoftohen për të marr pjesë në intervistë.

Njoftimet për kandidatët e kualifikuar, do të bëhen nëpërmjet postës elektronike.